



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më
05.01.2022, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Arianit Beqiri (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Berat Lahu (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Triera Kasumi-Berisha (LVV), Rashit Gashi (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitija (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Violeta Salihu (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Berna Saraçi (LVV), Rita Zariqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Fehmi Kupina (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Krenar Xhaferi (LDK), Izet Sadiku (LDK), Milazim Vitija (LDK), Donat Lushaku (LDK), Fadil Aliu (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Donjeta Dragusha (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Ilirik Musliu (PDK), Granit Geci (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Plator Gerdovci (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Besianë Musmurati (PDK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Arbnora Ajeti (AAK), Gëzim Mehmeti (AKR), Fiknete Bejta (AKR), Sami Boroci (AKR), Endrit Zabërgja, (NISMA) dhe Agim Kuleta (LB).

Të pranishëm ishin edhe: Përparim Rama, kryetar i Komunës, dhe Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të KFOR-it dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Milazim Vitija dhe propozoi këtë

REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese;
2. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
3. Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa;
4. Caktimi i grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2022;
5. Pyetje dhe përgjigje;
6. Të ndryshme.

Faqe nga 4

Para se të fillohej me diskutimin e pikave të rendit të ditës, kryesuesi kërkoi nga anëtarët e rinj të Kuvendit që të bëjnë betimin para Kuvendit. Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajqinovci (LDK), Arianit Beqiri (LVV), Taulant Maxharraj (AAK) dhe Besianë Musmurati (PDK) u betuan para Kuvendit.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes inauguruese.

Pika e dytë

Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi i mbledhjes në pika të shkurtra i njoftoi të pranishmit rreth zhvillimit të procedurës për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës, duke thënë se paraprakisht duhet të formohet një komision për mbarëvajtjen e punës dhe mbikëqyrjen e procedurës së votimit të zgjedhjes së kryesuesit.

Kryesuesi i mbledhjes kërkoi nga partitë politike që t'i bëjnë propozimet e tyre për anëtarë të komisionit.

Nga GP i LVV-së u propozua Nora Kelmendi, nga GP i LDK-së u propozua Sami Salihu dhe nga GP i PDK-së u propozua Agron Canolli.

U konstatua se njëzëri u formua Komisioni vlerësues, në përbërje prej tre (3) anëtarëve për mbarëvajtjen dhe mbikëqyrjen e procedurës së votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit.

Pas formimit të komisionit, kryesuesi i mbledhjes kërkoi nga subjektet e partive politike që t'i japin propozimet e tyre për kryesues të Kuvendit.

Nga GP i LDK-së, për kryesues të Kuvendit u propozua Fehmi Kupina, ndërsa subjektet tjera politike nuk dhanë asnjë propozim.

Në dy rastet e para të votimit, kandidati i propozuar për kryesues të Kuvendit nuk e arriti numrin e mjaftueshëm të votave për t'u zgjedhur kryesues.

Komisioni konstatoi se pas herës së tretë të votimit, me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit, më 25 vota për, z. Fehmi Kupina zgjidhet kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit, falënderoi të gjithë anëtarët e Kuvendit që votuan pro zgjedhjes së tij për kryesues të Kuvendit. Ai njëherësh para Kuvendit u zotua se do të zbatojë me përpikëri çdo normë juridike, procedurale, administrative, të cilat janë obligim për kryesuesin dhe Kuvendin e Komunës.

Pika e tretë

Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi tha se Komiteti për Politikë dhe Financa duhet t'i ketë njëmbëdhjetë anëtarë, bashkë me kryesuesin.

Tani duhet të paraqiten propozohen nga subjektet politike.

Nga subjekti politik LVV të propozohen katër anëtarë, nga subjekti politik i LDK-së tre anëtarë, nga subjekti politik i PDK-së dy anëtarë, dhe nga subjekti politik i AAK-së një anëtar.

Sami Boroci bëri vërejtje rreth përbërjes së komitetit, duke thënë se në Komitetin për Politikë dhe Financa duhet të jetë i përfaqësuar edhe subjekti politik i AKR-së, meqenëse kryesuesi është me automatizëm i përfaqësuar në komitet, atëherë kjo duhet të kalkulohet nga numri dhjetë e jo nga numri njëmbëdhjetë, e që i bie se edhe AKR-ja duhet me qenë e përfaqësuar në KPF.

Lidhur me këtë kërkoi një interpretim ligjor edhe nga Zyra ligjore.

Për këtë vërejtje dhe shqetësimin e ngritur nga z. Boroci, sqarime të nevojshme dha Fatos Dibra, përfaqësuesi i Zyrës ligjore.

Fiknete Bejta tha se përderisa në mandatin paraprak ne ishim të përfaqësuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, pse tash po anashkalohe mi, kur është e njëjta formulë e përlllogaritjes që e jep saktësisht se edhe AKR-së i takon një anëtarë në KPF.

Milazim Vitija kërkoi nga kryesuesi që me rastin e propozimeve për anëtarë të KPF-së të merret parasysh edhe struktura gjinore.

Gëzim Mehmeti theksoi se në mandatin e kaluar AKR-ja ka qenë e përfaqësuar në KPF, prandaj mendoj se po bëhet shkelje, që ne si subjekt politik po anashkalohe mi nga përfaqësimi në këtë komitet. Si subjekt politik, do t'i shfrytëzojmë të gjitha mjetet juridike për ta kundërshtuar këtë vendim të Kuvendit.

Kryesuesi kërkoi nga partitë politike që t'i japin propozimet e tyre.

Nga subjekti politik LVV, u propozuan: Nora Kelmendi, Arbnora Berisha, Mirsad Vitia dhe Gëzim Sveçla.

Nga subjekti politik LDK, u propozuan: Jeta Rafuna - Hasani, Donat Lushaku dhe Donjeta Dragusha.

Nga subjekti politik PDK, u propozuan: Shegë Beqiri dhe Plator Gërdovci.

Nga subjekti politik AAK u propozua Bahri Gashi.

Bazuar në propozimet e dhëna, kryesuesi konstatoi se më 40 vota për dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e katërt

Caktimi i grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2022.

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit se ky grup punues do të udhëhiqet nga kryesuesi i Kuvendit, si dhe do të përfaqësohen me nga një anëtar të gjitha subjektet politike, një përfaqësues i Zyrës ligjore, një nga ekzekutivi dhe një nga Shërbimi i Kuvendit.

Për këtë grup punues u propozuan: Feim Osmani, Fisnik Osmani, Granit Geci, Valbona Vitia - Ajeti, Gëzim Mehmeti, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Alban Zogaj, nënkryetar i Komunës, përfaqësues nga ekzekutivi dhe Luljeta Selimi, përfaqësuese nga Shërbimi i Kuvendit.

Me propozimet e dhëna, kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 42 vota për, u miratua Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2022.

Pika e pestë Pyetje dhe përgjigje

Gëzim Sveçla kërkoi nga administrata e Kuvendit sqarim lidhur me heqjen e flamurit kombëtar nga salla e Kuvendit. Njëherësh ai kërkoi që kjo të rregullohet për seancën e ardhshme të Kuvendit.

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Sveçla, kryesuesi tha se prezenca e flamurit kombëtar nuk parashihej në protokoll.

Sami Boroci kërkoi nga kryetari i Komunës, që të shihet mundësia e ofrimit në dispozicion të një zyre për grupet parlamentare të subjekteve politike, ku do t'i kishim mbajtur takimet e ndryshme, qoftë me qytetarë apo grupe më të vogla.

Përparim Rama, kryetar i Komunës, tha se patjetër që ne jemi në proces për gjetjen e një hapësire të mundshme në këtë objekt, por edhe në ndërtesat tjera, siç është edhe objekti i ri i Komunës, ku mund të kemi hapësirë për grupe punuese. Po ashtu, do të shihet mundësia edhe për medie që të kenë hapësirë punuese, për t'ua bërë të mundshme takimet edhe me pjesëtarë të ndryshëm të qytetit.

Donat Lushaku tha se sipas Ligjit për përdorimin e simboleve, nuk obligohet asnjë institucion të mbajë flamurin kombëtarë, kështu që institucionalisht është i obligueshëm flamuri i Kosovës dhe ai i Prishtinës, sepse Prishtina është kryeqytet i Kosovës dhe jo kryeqytet i Shqipërisë.

Arbër Vokri theksoi se nuk besoj që edhe ka ndonjë rregullore që obligon largimin e flamurit, por ai është flamur kombëtar shqiptar, kështu që nuk di pse të na vije keq ose marre, ose neveri për praninë e simbolit tonë kombëtar në sallën e Kuvendit.

Fiknete Bejta ngriti shqetësim rreth një dukurie, duke thënë se te shkolla "Naim Frashëri", përball me Stacionin e policisë, rastisin dritaret e klasave të para janë përball kampit ose Stacionit të policisë ku arrestohen të burgosurit e krimeve të rënda, e që unë konsideroj se nuk është një pamje e mirë. Andaj lus kryetarin që në të ardhmen ta trajtojë këtë problem, në mënyrë që të eliminohet kjo pamje për fëmijët e shkollave fillore.

Mbledhja mbaroi në orën 14:30.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fehmi Klupina**



Faqe4nga4